



Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Komora inxhenera Republike Kosovo
Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo

Mjesia org. OIRK
Org. Jedinica
Org. Unit
Nr. i tagjeve 1
Br. Stranica
Nr. Pages

M. i Prot. 764/2025
Broj Prot. 764/2025
Prot. No.
Data: 18.09.2025
Datum:
Date:
No.1

PRISHTINË / A

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KRPP - RKJN - PPRC

Nr. 77 / 2025
Dt. 18.09.2025

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I LIDHUR NDËRMJET

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (OIRK)

DHE

KOMISIONI RREGULLATIV PËR PROKURIM PUBLIK (KRPP)

Prishtinë,
Data 18.09.2025

Duke marrë parasysh rëndësinë e transparencës, profesionalizmit dhe konkurrencës së ndershme në fushën e prokurimit publik; Duke njohur rolin e pazëvendësueshëm të inxhinierëve të licencuar në sektorin e ndërtimit publik; Duke u mbështetur në frymën e bashkëpunimit institucional dhe respektimit të plotë të legjislacionit në fuqi; Palët, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012 “Për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit”, Ligjin Nr. 04/L-042 “Për Prokurimin Publik”, dhe aktet nënligjore përkatëse, lidhin këtë:

Memorandum mirëkuptimi

Palët pjesëmarrëse:

Ky Memorandum bashkëpunimi lidhet me datën xx gusht 2025, ndërmjet:

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK)
Adresa: Kompleksi Rilindja, Kontejneri nr. 3, Kati 2, 10000 Prishtinë.

Komisioni Rregullativ për prokurim Publik (KRPP)
Adresa: Ndërtesa e germisë, zona B, 10000 Prishtinë

Neni 1

Qëllimi i Memorandumi

1. Ky Memorandum ka për qëllim vendosjen e një kuadri bashkëpunimi ndërmjet OIRK dhe KRPP-së për të:
 - 1.1 Siguruar respektimin e plotë të dispozitave ligjore që ndërlidhen me pjesëmarrjen e inxhinierëve të licencuar në procedurat e prokurimit publik në sektorin e ndërtimit;
 - 1.2 Minimizimin e kriterëve diskriminues apo të pajustificuara në dokumentet e tenderimit që nuk bazohen në ndonjë dispozitë ligjore apo akt nënligjor në fuqi;
 - 1.3 Rritjen e transparencës, profesionalizmit dhe mbrojtjen e konkurrencës së ndershme në fushën e ndërtimit publik.

Neni 2

Baza Ligjore

1. Ky Memorandum mbështetet në:
 - 1.1 Ligji Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit;
 - 1.2 Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;
 - 1.3 Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim;
 - 1.4 Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;
 - 1.5 Ligji për Eficiencën e Energjisë;
 - 1.6 Aktet nënligjore dhe udhëzimet përkatëse.

Neni 3

Angazhimet e OIRK-së

1. Të publikojë (në ueb faqe të OIRK apo Ministrisë përkatëse) listën zyrtare dhe të përditësuar të inxhinierëve të licencuar sipas drejtimeve dhe specializimeve, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012;
2. Të bashkëpunojë me KRPP-në në promovimin, përgatitjen dhe shpërndarjen e udhëzimeve për autoritetet kontraktuese lidhur me kërkesat profesionale në dokumentet e tenderëve;
3. Të ofrojë këshilla ligjore dhe profesionale për shmangien e kriterëve diskriminues që bien ndesh me kuadrin ligjor të aplikueshëm.

Neni 4

Angazhimet e KRPP-së

1. Të sigurojë përfshirjen e qartë të dispozitave ligjore në dokumentet standarde dhe udhëzimet për autoritetet kontraktuese, me qëllim që profesionistët në fushën e ndërtimit të jenë inxhinierë të licencuar nga OIRK, në përputhje me ligjin;
2. Të ofrojë udhëzime dhe rekomandime për shmangien e kërkesave shtesë në dokumentet e prokurimit, kur ato nuk janë të bazuara në ndonjë ligj apo akt nënligjor të aplikueshëm;
3. Të rekomandojë autoriteteve kontraktuese që, në rastet kur kërkohen certifikata ose licenca shtesë (p.sh. siguri në punë, mbrojtje nga zjarri, ndikim në mjedis, trashëgimi kulturore etj.), ato të lidhen me kompetencën e ekipit profesional apo edhe vetë kompanisë dhe jo të imponohen mbi një person të vetëm/inxhinierë apo profesione të tjera, përveç rasteve kur një kërkesë e tillë është e përcaktuar qartë me ligj.

Neni 5

Parimi i Bazës Ligjore dhe Mosdiskriminimit

4. Të gjitha kërkesat për dokumentacion profesional në tenderë duhet të kenë bazë të qartë ligjore ose nënligjore dhe të jenë të përcaktuara në mënyrë të arsyetuar;
5. Nuk është e lejuar të kushtëzohet pjesëmarrja e një inxhinieri me posedimin e certifikatave shtesë përveç licencës, nëse këto certifikata nuk janë të kërkuara nga ndonjë dispozitë ligjore;
6. Në rast të nevojës për kompetenca shtesë, duhet të lejohet që ato të mbulohen nga pjesëtarë të tjerë të ekipit të projektit, dhe jo domosdoshmërisht nga vetë inxhinieri kryesor i angazhuar.

Neni 6

Personat kontaktues

1. Palët bien dakord të formojnë një pikë të përbashkët kontakti të formatit teknik për të shqyrtuar zbatimin e këtij memorandum;
2. Pika e kontakti do të identifikojë rastet e kriterëve diskriminuesë, do të ofrojë interpretime të përbashkëta dhe do të propozojë përmirësime në dokumentet model të prokurimit;
3. OIRK dhe KRPP do të organizojnë trajnime të përbashkëta për autoritetet kontraktuese dhe palët e interesit nga fushat që mbulojnë.

Neni 7

Kohëzgjatja dhe Rishikimi i Memorandumit

1. Ky memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të jetë i vlefshëm për një periudhë prej tre (3) vitesh, me mundësi të rinovimit me marrëveshje të ndërsjellë. Çdo ndryshim në këtë memorandum mund të bëhet vetëm me pajtimin e të dyja palëve.

PALËT NËNSHKRUESE

Arsim Rapuca

Kryetar i Odës së Inxhinierëve
të Republikës së Kosovës



Osman Vishaj

Kryetar i Komisionit Rregullativ
për Prokurim Publik

